

2022/2 prot

Dt. 27. 10. 22

## AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE



## PLANI I INTEGRITETIT

2022-2024

## DEKLARATA E INTEGRITETIT

Lufta efektive kundër korruptionit nga ana e institucioneve ligjzbatuese është me rëndësi jetike për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional.

Integriteti institucional në sektorin publik përbën përpjekjet e përbashkëta për të luftuar përiashtimin, pabarazinë dhe mosbesimin në institucionet publike. Këto tre “sëmundje” përmbledhin koston e korruptionit.

Në këtë kontekst, planet e integritetit jo vetëm do të forconin institucionin për të parandaluar korruptionin përmes kurimit të simptomave, por njëherazi do të kontribuojnë në përfitimin e një kulture të menaxhimit publik, me etikë dhe integritet si gurë themeli i një bashkëqeverisje të mire.

Në zbatim të masave të planifikuara në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korruptionit dhe Planin e Veprimit, si dhe përbushjen e standardeve dhe detyrimeve të Shqipërisë në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, si institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme, ka përgatitur Planin e saj të Integritetit.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është një institucion mbikëqyrës i disa prej strukturave në varësi të Ministrisë së Brendshme, pjesë e Rrjetit të Vendeve Partnere kundër Korruptionit (EPAC/EACN) të BE, që prej vitit 2010, si dhe pjesë e platformës rajonale Anti – Korruption për Departamentet e Kontrollit të Brendshëm të agjencive ligjzbatuese dhe të kufirit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ngritur me ndihmën dhe asistencën e OSBE në Shqipëri.

Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e kornizës rregullatore dhe operacionale të integritetit. Transformimi i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në një Agjenci të Mbikëqyrjes Policore me atributet dhe përgjegjësi të shtuara për të luftuar korruptionin, si dhe për të parandaluar veprimtarinë e paligjshme në radhët e subjekteve të saj, ka qënë një domosdoshmëri për reformimin tërësor të strukturave të sigurisë dhe për t'i sjellë ato në standardet më të mira evropiane.

Miratimi i këtij Plani, është gjithashtu një përpjekje për të hedhur themelet e një sistemi më të gjërë, i cili do të rrisë integritetin institucional.

Syntezat tonë, të shprehura në këtë dokument, lidhen me krijimin e një mjedisi që nxit dhe promovon kulturën e integritetit, nëpërmjet një sistemi funksional të menaxhimit të riskut në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.

Besnikëria, trimëria dhe integriteti vendosin pritshmëritë për sjelljen, ato vendosin një standard për punën tonë, më shumë se sa thjesht një moto: Besnikëria, Trimëria dhe Integriteti duhet të jetë një mënyrë jetese.<sup>1</sup>

Jemi të vodosur dhe të sigurt së përmirësimi i integritetit në të gjitha nivelet, arrija e standardeve të larta profesionale dhe etike do të kontribuojë për të luftuar pa kompromis dhe goditur korruptionin, me qëllim forcimin dhe rritjen e besimit tek publiku.

Integriteti pa dituri është i dobët dhe i padobishëm dhe dituria pa integritet është e rrezikshme dhe e frikshme.<sup>2</sup>



---

<sup>1</sup> Cit. Robert Mueller

<sup>2</sup> Cit. Samuel L. Johnson

## PËRMBAJTJA

Deklarata e Integritetit.....	2
Lista e shkurtimeve.....	4
I. Hyrje.....	6
II. Qëllimi i dokumentit.....	7
III. Mbi metodologjinë dhe procesin.....	10
IV. Parimet dhe objektivat .....	11
V. Identifikimi i fushave me risk në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.....	11
1. Risqe në fushën e Inspektiveve/Ankesave.....	11
2. Risqe në fushën e hetimeve proaktive dhe procedimeve penale.....	13
3. Risqe në fushën e vlerësimit kalimtar dhe periodik.....	15
4. Risqe në fushën e hetimeve disiplinore.....	16
5. Risqe në fushën e verifikimit për pajisjen me CSP.....	17
6. Risqe në fushën e Prokurimit Publik.....	18
7. Risqe në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.....	18
8. Risqe në fushën e Menaxhimit Financiar.....	19
9. Risqe në fushën e arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit.....	20
10. Risqe që lidhen me cënimin e etikës, paanshmërinë, dinjitetit, mbrojtjen e reputacionit dhe imazhit të institucionit.....	20
VI. Monitorimi dhe raportimi.....	21
VII. Konkluzione dhe rekomandime.....	21

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

- |      |   |
|------|---|
| AMP  | - Agjencia e Mbikëqyrjes Policore                       |
| DSIK | - Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar |
| GP   | - Grupi i Punës   |
| GR   | - Garda e Republikës                                    |
| MB   | - Ministria e Brendshme                                 |
| MVRI | - Metoda e Vlerësimit të Riskut të Integritetit         |
| MZSH | - Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin       |
| PI   | - Plani i Integritetit                                  |
| SNKK | - Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit         |
| VKM  | - Vendim i Këshillit të Ministrave                      |

## I. HYRJE

Integriteti gjithnjë e më shumë shikohet si dimension themelor i një qeverisje demokratike. Plan i Integrititetit është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës ligjore që i dyfishon masat që kanë për qëllim ruajtjen e integrititetit institucional të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Po ashtu ka për qëllim arrijen e objektivave të Agjencisë në adresimin dhe menaxhimin e fushave me risk të lartë.

Ky plan parashevë një prespektivë më të gjerë, atë të forcimit të kapaciteteve, rritjes së vetëdijes, përmirësimit dukshëm të rregullave dhe praktikave kundër korruptionit dhe inkurajimin e sjelljeve etike dhe profesionale.

Korruptioni vazhdon të mbetet një ndër problematikat më të mprehta me të cilat përballen shoqëritë sot. Ky fenomen është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një shteti.

Lufta kundër korruptionit është në thelb një luftë për modernizimin e shtetit dhe vazhdon të jetë në listën e përparësive më të rëndësishme të politikbërjes duke mbetur një ndër sfidat parësore jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të shteteve të tjera me demokraci mjaft të zhvilluara, në kuadër të së cilës janë ndërmarrë hapa galopantë.

Objktivi ynë primar është të forcohet besimi i qytetarëve tek institucionet publike dhe të rritet shkalla e besimit tek puna dhe reformat që po ndërmerren.

Korruptioni luftohet dhe minimizohet me veprime të koordinuara, institucione të konsoliduara e mbi të gjitha me një kuadër ligjor të plotë.

Koncepti i integritetit është vlerësuar më gjëresisht dhe përfshin në vetvete jo vetëm ndershmërinë dhe mungesën e korruptionit, por dhe një sërë aspektesh të tjera që përbëjnë menaxhimin publik, të tilla si: etika, sjella dhe komunikimi profesional, standardet, vlerat, konfidencialiteti, transparenca, paanshmëria dhe llogaridhënia, garantimi i të cilave krijon një barrierë mbrojtëse ndaj korruptionit.

Në mënyrë të veçantë njojja dhe vlerësimi i thelluar i risqeve të korruptionit në institucionet e sigurisë publike dhe ato ligjzbatuese, konsiderohet edhe më thelbësore për të ndërtuar qasjen e duhur kundër tij dhe për t'a luftuar në mënyrë efektive nëpërmjet politikave konkrete parandaluese e proaktive, konsolidimit të proceseve dhe rritjes së profesionalizmit dhe integritetit.

Në këtë kuadër, është përgatitur Plani i Integritetit të AMP-së, si një dokument strategjik dhe mekanizëm efektiv për menaxhimin e risqeve potenciale të integritetit në fushat e veprimtarisë së institucionit, të tilla si:

- në fushën e Inspektiveve/Ankesave
- në fushën e hetimeve proaktive dhe procedimeve penale
- në fushën e vlerësimit kalimtar dhe periodik
- në fushën e hetimeve disiplinore
- në fushën e verifikimit për pajisjen me CSP
- në fushën e Prokurimit Publik
- në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- në fushën e Menaxhimit Financiar
- e në fushën e arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit
- në fusha që lidhen me cënimin e etikës, paanshmërinë, dinjitetit, mbrojtjen e reputacionit dhe imazhit të institucionit

Plani i Integritetit, paraqet vizionin strategjik që synon konsolidimin e integritetit të individëve dhe gjithë strukturës të Agjencisë. Ky dokument i rëndësishëm pohon angazhimin tonë institucional për të përbushur me profesionalizëm dhe integritet misionin në shërbim të qytetarëve.

Plani është një instrument që do të kontribuojë në mënyrë të qenësishme në menaxhimin e riskut ndaj fenomenit të korrupsionit, dhe në rritjen e nivelit të integritetit, efikasitetit dhe llogaridhënieς në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Ky dokument strategjik është në përputhje me prioritetet e parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2022-2024 dhe në standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

Qëllimi i tij është që të kontribuojë në fuqizimin e kapaciteteve për të minimizuar dukuritë negative që cenojnë integritetin. Nëpërmjet tij, synohet rritja e integritetit dhe ulja e korrupsionit. Këta komponentë janë kompleksë, dinamikë dhe të vazhdueshëm.

Agjencia ka ndërmarrë angazhimin për t'u përkujdesur për një performancë dhe kulturë të lartë në luftën kundër korrupsionit në sektorët më vulnerabël dhe të ndjeshëm ndaj korrupsionit, për t'u siguruar që strukturat që në mbikqyrinë në të gjitha nivelet të janë eficiente, të kenë integritet të lartë, të janë të kujdeshme gjatë ushtrimit të detyrave të tyre si dhe të janë të përgatitura për të luftuar praktikat korruptive që cenojnë mirëfunkcionimin e sistemit.

Nga ana tjeter, pjesëmarrja aktive qytetare nëpërmjet ankesave dhe denoncimeve të adresuara drejtpërdrejt në institucion është një domosdoshmëri dhe garanci e shtuar për ruajtjen e integritetit.

## II. QËLLIMI I DOKUMENTIT

Plani i Integritetit i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore është një dokument i nivelit strategjik me një natyrë operacionale, i cili ka si qëllim nga njëra anë të identifikojë risqet ndaj integritetit në strukturat e saj dhe të vlerësojë nivelin e cënueshmërisë së tyre dhe nga ana tjetër të planifikojë masat e duhura për parandalimin dhe minimizimin e tyre.

Gjithashtu ky Plan, ka për qëllim identifikimin dhe vënien në funksion të mekanizmave për minimizimin e faktorëve që mund të lidhen me arsy, presione, raste apo mundësi të krijuara, e që shërbejnë si bazë për ekzistencën e korruptionit, duke synuar në këtë mënyrë menaxhimin e risqeve dhe garantimin kurdoherë të shërbimeve cilësore, të paanshme e të përgjegjshme ndaj qytetarit.

Në këtë kontekst, ky dokument do të shërbejë si një mjet parandalues gjithëpërfshirës kundër korruptionit, pasi synon promovimin dhe forcimin e integritetit duke përfshirë këtu integritetin individual, profesionalizimin, etikën, si dhe zbatimin e vlerave morale dhe standardeve profesionale.

Në vazhdën e përpjekjeve për të konsoliduar institucionin dhe mbrojtjen e tij nga cënimi i integritetit, ky dokument synon të luajë një rol kyç për:

- Menaxhimin e rrezikut të integritetit në të gjitha strukturat dhe fushat më të ekspozuara ndaj risqeve të korruptionit;
- Angazhimin e strukturave drejtuese, zhvillimin e kapaciteteve, forcimin e mekanizmave mbikëqyrës, evidentimin e parandalimin e sjelljeve korruptive e abuzuese, rritjen e vetëdijes e kulturës nga të gjithë punonjësit, dekurajimin e “kulturës së heshtjes” dhe inkurajimin e denoncimit të veprimeve korruptive, diskriminuese dhe që shkelin etikën profesionale e institucionale.
- 

## III. MBI METODOLOGJINË DHE PROCESIN

Plani i Integritetit dhe Plani i tij i Veprimit janë hartuar në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI), miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr. 334, datë 07.10.2020 “*Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qëndrore*”, dokument i cili i është referuar Standardeve ISO 31000 dhe 31010<sup>3</sup>, të përshtatura për analizën e riskut të integritetit, gjithashtu dhe duke shfrytëzuar metodat dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit për AMP-në kaloi në fazat si më poshtë:

## 1. AMP ngriti grupin e punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe mobilizimin e stafit.

U ngrit grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit i përbërë nga përfaqësues të strukturave të institucionit. Gjithashtu u hartua një plan pune, ku u përcaktuan afatet, masat dhe aktivitetet e planifikuara, me qëllim përgatitjen dhe përfundimin në kohë të Planit të Integritetit dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij.

## 2. Identifikimi dhe analiza e riskut.

Grupi i Punës u angazhua për përgatitjen e një analize të thelluar dhe të bazuar në specifikat e strukturave të përfshira, duke shqyrtuar në mënyrë të hollësishme çdo aspekt dhe proces pune. Ky proces përfshinte disa komponentë, si më poshtë:

- Analizë e kuadrit ligjor sipas sektorëve lidhur me risqet në aspektin e ligjshmërisë, qartësisë, qëndrueshmërisë, mangësive ligjore;
- Analizë lidhur me organizimin e brendshëm, duke përfshirë strukturën organizative, shpeshtësinë e ndryshimeve organizative, problematikat që dalin si rezultat i ndryshimeve strukturore;
- Analizë e procesit të zinxhirit vendimmarrës, rekrutimi dhe procedurat e karrierës, prokurimet;
- Identifikimi i burimeve dhe disponimi i të dhënave përkatëse përfshirë dhe të dhënat statistikore, posedimi dhe aksesi në këto të dhëna, transparenca, pikat e forta dhe kufizimet e të dhënave, mbrojtja e të dhënave;
- Identifikimi i fushave, aspekteve, proceseve, shërbimeve dhe strukturave më të ndjeshme dhe të ekspozuara ndaj korruptionit si dhe arsyet e identifikimit të tyre;
- Raste dhe fusha ku janë identifikuar ngjarje korruptive në të kaluarën, një studim i thelluar statistikor mbi rastet e kaluara, duke i kategorizuar këto raste në shkelje etike, thyerje disiplinore apo administrative dhe vepra penale;

Menaxhimi i rrezikut të integritetit nëpërmjet kësaj metodologjie ndihmoi për t'i përgjigjur pyetjeve thelbësore të lidhura me qëllimin e aktiviteteve/proceseve.

- Çfarë mund të ndodhë dhe pse?
- Cilat mund të jenë pasojat?
- Cili është probabiliteti që ato të ndodhin sërisht?
- A ka faktorë të cilët mund të zgjedhjnë pasojat e rrezikut apo që mund të zgjedhjnë probabilitetin e rrezikut?
- Cilat janë tendencat e rreziqeve dhe pasojat e masave eventuale të vendosura në zbatim për t'i parandaluar ato?

Standardi EN 31010 (manuali për zbatimin e ISO 31000) shërbeu si udhëzues drejt përzgjedhjes dhe zbatimit të teknikave sistematike për menaxhimin e rrezikut.

Procesi i menaxhimit të rrezikut, siç përcaktohet në ISO 31000, është kryer duke ndjekur fazat e mëposhtme:

- *komunikimi dhe konsultimi;*
- *përcaktimi i kontekstit;*
- *vlerësimi i rrezikut (përfshirë identifikimin e rrezikut, analizën e rrezikut dhe vlerësimin e rrezikut);*
- *përballimi i rrezikut;*
- *monitorimi dhe rishikimi.*

Bazuar në këtë metodologji u krye identifikimi i risqeve për të gjitha proceset dhe fushat e ndryshme si dhe për të gjitha nivelet, ku u vlerësuan si potencialisht të riskuara apo të ekspozuara në drejtim të cënimit të integritetit të punonjësve dhe të institucionit. Rrisjet e identifikuara u konceptuan dhe kategorizuan në disa grupe e fusha të mëdha rizu; në fushën e hetimeve, inspektimeve, ankesave, verifikimit për pajisjen me CSP, në kryerjen e procesit të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik, në hetimin disiplinor të subjekteve, në fushën e prokurimit publik, në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, në fushën e menaxhimit financiar, në fushën e arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit si dhe risqe të lidhura me shkeljen e etikës, paanshmërisë, cënimin e dinjitetit, reputacionit dhe imazhit të institucionit.

Në përfundim të procesit të analizës së fushave të riskuara u hartua “Matrica e Riskut të Integritetit” bazuar në standardet ISO 31000, sipas fazave të mëposhtme:

- *Identifikimi i zonave, proceseve dhe aktiviteteve të ekspozuara ndaj risqeve të korruptionit;*
- *Identifikimi i risqeve të mundshme për korruption;*
- *Analizimi i riskut – analiza e pasojave;*
- *Analizimi i riskut - vlerësimi i probabilitetit;*
- *Analizimi i riskut - vlerësimi i efektivitetit të të gjitha kontolleve ekzistuese;*
- *Analizimi i riskut – vlerësimin e nivelit të riskut;*
- *Vlerësimi i riskut;*
- *Identifikimi i masave për parandalim dhe luftim;*
- *Vlerësimi i efekteve të masave të luftimit, për objektiva afat-gjata, shumëvjeçare;*
- *Monitorimi dhe përsëritja e procesit.*

Qëllimi final i kësaj Matrice, u konkretizua me hartimin e Planit të Integritetit të AMP-së, i cili përmban:

- vlerësimimin e risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e Agjencisë për të përmbushur funksionin e institucionit në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme;
- formulimin e masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

#### **IV. PARIMET DHE OBJEKTIVAT**

Plani i Integritetit bazohet në parimet e mirë përcaktuara në Ligjin 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, përkatësisht:

- a) ligjshmëria;
- b) pavarësia nga subjektet ndaj të cilave ushtrohet mbikëqyrja;
- c) objektiviteti dhe paanshshmëria;
- ç) profesionalizmi dhe ndershmëria në ushtrimin e detyrave;
- d) transparenca;
- dh) shmangia e konfliktit të interesit;
- e) proporcionaliteti;
- ë) ruajtja e konfidencialitetit dhe sekretit hetimor;
- f) llogaridhënia;
- g) mosdiskriminimi dhe barazia gjinore
- gj) respektimi i lirive dhe te drejtave te njeriut.

Plani i Integritetit është i konceptuar në fryshtëzimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme, i shtrirë në periudhën 2022-2024, i cili synon realizimin e disa objektivave kryesore:

- Fuqizimin e kapaciteteve për të minimizuar dukuritë negative që cënojnë integritetin;
- Parandalimin e korruptionit dhe forcimin e integritetit institucional;
- Krijimin e mekanizmave monitorues mbi sjelljet që cënojnë integritetin;
- Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në kuadër të përmbushjes së detyrimeve dhe objektivave strategjikë në fushën e antikorrupsonit.

#### **V. IDENTIFIKIMI I FUSHAVE ME RISK NË AGJENCINË E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nisur nga përfundimet dhe rezultatet e analizuara në Matricës e Riskut të Integritetit si dhe bazuar në Planin e Veprimit për jetësimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme 2022-2024 janë identifikuar këto fusha me risk korruptioni pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore:

## 1. Risqet në fushën e Inspektimeve/Ankesave

A. Agjencia nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit inspekton në vazhdimësi veprimtarinë e subjekteve të Agjencisë.

Veprimtaria inspektuese si pjesë e gjithë konfiguracionit të mbikëqyrjes dhe monitorimit pranë AMP-së, siguron përbushjen e detyrave institucionale dhe parandalimin e veprimtarisë së kundërligjshme të kryera nga subjekte të cilat ne mbikëqyrim, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë administrative apo penale për subjektet përgjegjëse, nëpërmjet:

- inspektimeve të planifikuara dhe të paplanifikuara:

Në kuadër të veprimtarisë inspektuese punonjësit e AMP-së përballen me:

1. mosevidentim konkret të përgjegjësive të subjekteve, gjatë inspektimit të strukturave dhe mosreferimi i mëtejshëm për procedim disiplinor apo penal.
2. mosprocedim i subjekteve të përfshira në aktivitet të kundraligjshme të tilla si:
  - *Fenomeni i "shpërdorimit të detyrës", i evidentuar në forma të ndryshme dhe shkallë shtrirje nga niveli më i ulët deri tek nivelet e funksionet e larta menaxheriale. Vazhdon të jetë një nga format mbizotëruese të paligjshmërisë, i cili lidhet ngushtësisht me ndërveprimin korruptiv, pra përfitimin, kjo vjen si rrjedhojë e favorizimit apo deri diku dhe e implikimit të individëve të veçantë në veprimitari të kundërligjshme si:
    - *Kultivimi i bimëve narkotike,*
    - *Trafiku i drogave të forta, nëpërmjet kufirit tokësor e detar,*
    - *Ndërtimet pa leje, kryesisht në zonat turistike apo zonat e mbrojtura,*
    - *Kontrabanda, kryesisht në PKK,*
    - *Kalimi i paligjshëm i kufirit (klandestinët) nëpërmjet dy linjave;*
      - o *Linja nga jashtë – brenda vendit, kryesisht e klandestinëve që vijnë nga vendet e lindjes (sirianë) me qëllim shfrytëzimin e vendit tonë si vend transit drejt vendeve të BE-së;*
      - o *Linja nga brenda – jashtë vendit, kryesisht shtetas shqiptarë (punëtorë sezonale drejt vendeve fqinje Greqi e Itali) por që kanë probleme hyrje – dalje në sistemin e vendeve Shengen, etj.**
  - *Fenomeni i kryerjes së “veprimeve arbitrale të punonjësve të policisë” si:*
    - *Mungesa e njohurive të punonjësve të policisë në lidhje me procedurat standarde të punës së tyre,*
    - *Mos respektimi procedurave standarte sidomos në qarkullimin rrugor;*
    - *Ushtrimi i dhunës në marrëdhëniet familjare ndaj bashkëshortëve, ndaj fëmijëve apo dhe ndaj prindërve;*
    - *Ushtrimi i ndikimit në zgjidhjen e konflikteve të pronësisë në familje apo në fis;*
    - *Komunikimi jo etik me individin/komunitetin;*
    - *Ushtrimi i forcës (disa raste armën) jashtë kritereve ligjore;*

- *Përcaktimi i përgjegjësive apo procedimi i subjekteve ne tejkalim të kompetencave, duke u bazuar ne informacione të pavërtetuara apo subjektivizma personal;*
- **Kontaktet e papërshtatshme dhe lidhjet nepotike.**

**Për të minimizuar risqet në fushën e inspektimeve rekandomohet:**

- Përmirësimi i kapaciteteve inspektuese dhe formateve dhe përbajtjes së raportimeve të tyre, nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve për metodat inspektuese;
- Identifikimi i problematikës gjatë inspektimit si dhe përcaktimi i personave përgjegjës për shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit;
- Referimi në Prokurori i shkeljeve të kryera nga subjektit, të konstatuara gjatë inspektimit;
- Referimi per hetime adminisitrative, si një përgjegjësi e shtuar e AMP-së
- Intesifikimi i kontolleve dhe aktivitetit mbikëqyrës i strukturave përgjegjëse për konstatimin e rasteve të paligjshmërive,
- Ndërtimi i ekipeve të përbashkëta të inspektimit me përfaqësues të AMP-së dhe të PSH dhe analizimi i rasteve të paligjshmërive në të cilat janë të përfshirë subjektit e AMP-së.
- Rritja e cilësisë së informacioneve të mbledhura, të cilat duhet të bazohen në dyshimin e arsyeshëm dhe të dhëna të vërtetuara në mënyrë ligjore.

B. Një risk me potencial të shtuar për cënimin e integritetit të punonjësit dhe të vetë institucionit, mbart edhe struktura e ankesave pranë Drejtorisë së Inspektim/Ankesave, e cila mer, administron dhe trajton ankesat që vijnë nëpërmjet: paraqitjes së shtetasit pranë Zyrës së Pritjes së Qytetarëve apo telefonatës në linjën e gjelbër, dërgimit të ankesës nëpërmjet postës zyrtare, *e-mail*-it, rrjeteve sociale, medias, portaleve denoncuese, raporteve zyrtare, komunikatave ditore, me konstatim ose iniciativë të punonjësit të Agjencisë.

Ofrimi i këtij shërbimeve përmes kontaktit dhe shkëmbimit fizik, mbart potencialisht risqe në lidhje me:

- mosverifikimi në kohë dhe me profesionalizëm i trajtimit të ankesave;
- marrjen dhe trajtimin e tyre në mënyrë preferenciale;
- mënyrën joligjore të trajtimit të ankesave;
- mosevidentim dhe mosreferim të rasteve të parashikuara nga ligji për hetimi disiplinor;
- mënyra e komunikimit të punonjësit me qytetarët;

**Rekomandohet marja e masave lidhur me përmirësimin e procedurave, garantimin dhe shtimin e vazhdueshëm të shërbimeve online nëpërmjet:**

- Përmirësimit të sistemit të menaxhimit të ankesave;

- Standardizimit të procedurave standarde të trajtimit të ankesave dhe i formave tip të marrjes së ankesës dhe kthim përgjigjeve;
- Kryerjes së hetimit administrativ interaktiv nga punonjësi i strukturës së ankesave;
- Referimit për hetim disiplinor të punonjësve që rezultojnë se kanë shkelur procedurat standarde të punës;
- Trajinimit vazhduese të punonjësve në lidhje me ankesat dhe hetimin disiplinor si kompetencë e shtuar e Agjencisë;
- Referimit për hetim penal në Prokurori të rasteve të inicuara nga ankesat e qytetarëve.

## 2. Risqet në fushën e hetimeve proaktive dhe procedimeve penale

Gjatë ushtrimit të kompetencave hetimore Agjencia përballet me riskun e abuzimit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale në rolin e oficerëve të policisë gjyqësore, veprimtarisë parandaluese dhe administrimi të informacioneve nëpërmjet:

- Tjetërsimit të provave në vendngjarje;
- Deformimit të deklarimeve të personave nën hetim apo personave që kanë dijeni përrrethanat e ngjarjes;
- Gjatë veprimtarisë së përditëshme punonjës të strukturave të hetimit, për shkak të aksesit që kanë tek informacionet e klasifikuar “sekret shtetëror” dhe “sekret hetimor” janë të ekspozuar ndaj riskut të nxjerrë së informacioneve në favor të personave të përfshirë në rekorde kriminale, si dhe dekonspirimit të aksioneve të Agjencisë dhe atyre të përbashkëta me PSH apo SPAK, si pasojë e nxjerrjes së këtij informacioni;
- “Mundësisë” për shkak të natyrës së veprimtarisë, përfavorizime të personave me aktivitet kriminal, ku është konstatuar se punonjës të caktuar kundrejt veprimeve korruptive bashkëpunojnë me persona me precedentë kriminale, duke u krijuar atyre favore në mos goditjen e tyre apo dhënë informacione në lidhje me veprimtarinë e policisë në drejtim të tyre.
- Mos kryerjes së veprimeve të ngutshme proceduriale hetimore në vendin e ngjarjes që janë të papërsëritshme si: kqyrjet, kontrollet e banesave, pyetja e personave që iu irrezikohetjeta, procesi i marrjes së provave në vendngjarje, sekuestrimi i sendeve në vendngjarje;
- Mosverifikimin e burimeve të informacionit dhe përmbajtjes së tij;
- Mos referimin në prokurori apo referimi në abuzim me ligjin bazuar në informacione të pavërtetuara.

**Për të rritur efektivitetin dhe integritetin e strukturës rekandomohet:**

- mbikëqyrje me e rreptë ndaj veprimeve procedurale që kryejnë oficerët e policisë gjyqësore;

- analiza të detajuara për veprat penale të cilat pushohen apo pezullohen, me qëllim identifikimin e veprimeve procedurale të kryera nga punonjësit nëse ka veprime që tjetërsojnë ngjarjen, ka veprime të paplota si këqyrjet të cilat janë të pa tjetërsueshme apo të papërsëritshme, të cilat ndikojnë në favorizime të mundshme të autorëve të veprave penale;
- vënia para përgjegjësisë administrative dhe penale i punonjësve që në abuzim me ligjin, nxjerrin informacione, tjetërsojnë provat, apo dekonspirojnë aksionet;
- referimi në prokurori i rasteve abuzive, si dhe “gjurmimi” i pasurive që ata disponojnë të cilat nuk justifikojnë të ardhurat e përfituarar në rrugë ligjore;
- përcaktimi i rregullave më të sakta për përdorimin e sistemeve si dhe rritja e monitorimin dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme ndaj personave që kanë akses në informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”;
- zbatimi efektiv i normave ligjore, përmirësimi i kapaciteteve përgjegjëse dhe miratimi i një qasje proaktive në drejtim të mbikëqyrjes, parandalimit dhe hetimit të fenomeneve korruptive;
- përdorimi i Metodave Speciale të Hetimit, çka do të kontribuojë në rritjen e performancës dhe uljen e riskut të korruptionit.

### **3. Risqet në fushën e vlerësimit kalimtar dhe periodik**

Procesi i Vlerësimit kalimtar dhe periodik përbën një kompetencë të re të shtuar me ligji 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet së cilës anëtarët e Trupave të Vlerësimit pranë AMP-së kryejnë veprimtarinë vlerësuese të subjekteve të përcaktuara në ligj, e cila përbën një faktor risku për shkak të:

- Natyrës së veprimtarisë verifikuese dhe vlerësuese të Trupës së Vlerësimit që prek interesa të drejtpërdrejta private dhe që ka një natyrë tepër sensitive;
- Vonesave në zhvillimin e hetimit administrativ duke tejkaluar afatet ligjore të përfundimit të procesit për shkaqe subjektive;
- Pozicionit të subjektit vlerësues dhe mundësisë për të ndikuar në vendimmarje;
- integritetit personal dhe profesional të anëtarëve të trupës vlerësuese,
- mundësisë së lartë të korruptionit;
- standardeve të shumëfishta të vlerësimit;
- impaktit që ka vendimmarrja finale;

Aktualisht ligji është në proces analizimi dhe rishikimi, me fokus kryesor adresimin e të gjitha problematikave të shfaqura gjatë zbatimit dhe implementimit të tij me qëllim përbushjen e misionit të ligjit dhe konkludimit në përfundim të procesit, të një trupe policore me integritet të lartë dhe me besueshmëri nga publiku.

## **Me qëllim përmirësimin dhe përbushjen e objektivave rekomandohet:**

- marrja e masave legislative dhe administrative për të patur një strukturë sa më profesionale, të pakorruptuar dhe me integritet të lartë;
- përcaktimi i kriterieve strikte në rekrutimin e punonjësve që do të ushtrojnë këtë detyrë;
- trajnimet e vazhdueshme për të gjitha komponentët e vlerësimit dhe ndryshimet ligjore;
- ushtrimi i kontrollit mbi mënyrën e kryerjes dhe mbarëvajtjen e procesit;
- standardizimi i procedurës së: vlerësimit kalimtar/periodik, procedurës së hedhjes së shortit, mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Trupave të vlerësimit, komunikimit me median dhe subjektin; mbrojtjen e të dhënavë personale dhe etikën e Trupave të Vlerësimit, me qëllim rritjen e transparencës dhe zhvillimin e procesit me paanshmëri;
- nënshtimi ndaj procesit të vlerësimit kalimtar të të gjithë punonjësve të Trupave Vlerësuese si një garanci e shtuar integriteti;
- hartimi i një database me të gjitha të dhenat e domosdoshme të procesit;

### **4. Risqet në fushën e hetimit disiplinor të subjekteve**

Në zbatim të nenit 40 të Ligjit 128/2021” Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, Agjencisë i është shtuar një kompetencë e re, ajo e hetimit për shkeljet e rënda disiplinore të kryera nga subjektit e saj, të cilat konstatohen nga vetë Agjencia gjatë veprimitarisë së saj mbikëqyrëse, gjë që shton riskun e korruptionit, për shkak të:

- Marrjes së kompetencës së vendimmarjes për masën disiplinore;
- Mundësisë për mosrespektim të garancive dhe të drejtave proceduriale të subjektit;
- Referimit mbi shkaqe subjektive dhe jo ligjore;
- Nivelit profesional dhe etik të anëtarëve të komisionit,
- Zhvillimit të hetimit nën ndikime dhe paragjykime të natyrës personale;

Për të menaxhur riskun e integrititetit në ushtrimin e kësaj kompetence ka menduar po ashtu edhe vetë ligjvënësi nëpërmjet garantimit të të drejtës proceduriale të ankimit ndaj një vendimmarje administrative, nëpërmjet krijimit të Komisionit të Apelimit ndërinstitucional ngritur me urdhër të Ministrit të Brendshëm, si shkallë e dytë e vlerësimit të ligjshmërisë së masës disiplinore gjithashtu rekomandohet;

- ngritja e një komisioni disiplinor pranë AMP-së me punonjës të kualifikuar profesionalisht dhe me integritet të lartë profesional;
- ushtrimit të kontrollit të brendshëm dhe monitorimit institucional të gjithë procesit;
- trajnim i vazhdueshëm dhe cilësor;
- unifikimi nëpërmjet procedurave standarde dhe formave tip, me qëllim shëmangien e standardeve të shumfishata në vendimmarje dhe respektimit të sigurisë juridike të subjektit nëpërmjet përfundimit në kohë të procesit disiplinor;
- zbatimi rigoroz i garancive dhe të drejtave proceduriale të parashikuara në ligj.

- zhvillimit të hetimit disiplinor bazuar në ligj dhe aktet nënligjore.

## 5. Risqet në fushën e verifikimit për pajisjen me CSP

Ajencja, si një autoritet verifikues ka në përbërje të saj strukturë të specializuara për kryerjen e verifikimeve të sigurisë ndaj individeve që do të njohin, do të prodhojnë, do të ruajnë, do të administrojnë, do të transportojnë dhe do të transmetojnë informacion të klasifikuar. Procedurat e aplikimit dhe verifikimit kryhen për pajisjen me “Certifikatën e Sigurimit të Personelit”, për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO-s dhe BE-së.

Veprimtaria e Verifikimit për pajisjen me Certifikate të Sigurimit të Personelit të subjekteve të Agjencisë cënohet nga rishku i integritetit sa i përket:

- ndjekjes në mënyrë permanente të pajisjes me CSP të punonjësve bazuar në nivelin e klasifikimit dhe detyrën/ funksionin organik që mbajnë, në emërimë/transferime.
- respektimit të afateve të CSP-së duke mos krijuar periudha të pa mbuluara ndërkohë që punonjësi vazhdon të punojë me informacionin e klasifikuar.
- Metodologjia e përdorur në lidhje me verifikimin dhe vlerësimin për pajisjen me CSP.
- përgjegjësisë së re të materializuar në ligjin e ri “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policor”, ku Agjencia mer përgjegjësinë për subjektet të udhëheqë procesi që nga faza fillestare e aplikimit e deri në përfundimin e plotë të praktikës, përbën një risk të shtuar të abuzimit.

### Në lidhje me sa më sipër rekomandohet:

- krijimi i një database për të kontrolluar e mbikëqyrur punonjësit që nuk janë të pajisur me CSP, apo që u mbaron afati e duhet riaplikuar.
- mbikëqyrje e vazhdueshme institucionale, me qëllim që punonjësit të mos vazhdojnë të njihen me informacionin e klasifikuar kur CSP-ja ju është refuzuar apo pezulluar;
- standardizim i procedurave në lidhje me shkëmbimin e informacionit, mënyrën e verifikimit dhe metodologjinë e vlerësimit të informacioneve dhe të dhënavë për pajisjen me CSP;
- krijimi i registrave të brifimit dhe debrifimit dhe rakordimi i të dhënëve me sistemin qëndror të të dhënavës në Autoritetin e Sigurisë Kombëtare.

## 6. Risqet në Fushën e Prokurimit Publik

Punonjësit e angazhuar në sektorët që merren me prokurimet publike me vlerë të vogël për mallra dhe shërbime si edhe me prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kanë objekt të punës së tyre:

- hartimin e dokumentave të tenderit;
- përcaktimin e kritereve dhe kushteve të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë, procese të cilat janë të riskuar në drejtim të:
  - Konfliktit të interesit me operatorët ekonomikë;
  - Qasjes subjektive dhe të qëllimshme në hartimin e dokumenteve të prokurimit, specifikimeve teknike ose termave të referencës për të favorizuar apo skualifikuar një operator ekonomik, duke krijuar pabarazi dhe diferencim në process;
  - Dhënies së informacionit konfidencial tek operatorët ekonomikë, për qëllime favorizuese;
  - Vlerësimit subjektiv të ofertave;
  - Mosrespektimi i procedurave të Prokurimit Publik me vlerë të vogël për mallra dhe shërbime si edhe me prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke përfshirë vonesat dhe specifikimeve jo të sakta.
  - Mosrespektimi i procedurave të prokurimit publik dhe mungesa e transparencës mund të çojë dhe në cënim të besimit të publikut tek ato dhe institucionit.

*Nga sa më sipër, janë parashikuar të merren masat e mëposhtme:*

- Plotësimi i deklaratës së konfliktit të interesit për çdo procedurë prokurimi, gjatë fazës së studimit të tregut dhe vlerësimit të ofertave nga operatorët ekonomikë, nëpërmjet së cilës synohet ulja e rasteve të konfliktit të interesit.
- Kryerja e trajnimeve periodike dhe të detyrueshme për rritjen e nivelit profesional të punonjësve të angazhuar në realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe mbi parandalimin e riskut në këtë fushë, ku synohet ulja e rasteve të denoncuara për praktika të hartuara në mënyrë abuzive.
- Kufizimi i diskpcionit të titullarëve lidhur me qëndrueshmërinë e anëtarëve të komisionit, bazuar në kritere vlerësimi nga mekanizma të ndryshëm kontrolli, brenda dhe jashtë institucionit.
- Nënshkrimi dhe respektimi i deklaratës së konfidencialitetit, si dhe hartimi, vlerësimi dhe shqyrtimi i procedurave të prokurimit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, nëpërmjet të cilave synohet ulja e rasteve të shkeljeve në procedurat e prokurimit publik.
- Njohja e çdo anëtarit të komisionit me procedurat e prokurimit publik për mallra dhe shërbime sipas ndryshimeve të reja ligjore;
- Përmirësim i hartimit të specifikimeve teknike duke përfshirë ekspertizën e duhur në to.
- Respektimi i kuadrit ligjor për prokurimet publike me vlerë të vogël për mallra dhe shërbime si dhe prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;
- Ndarja e qartë e detyrave të anëtarëve të komisionit duke mos u përfshirë në procesin e hartimit të specifikimeve teknike.

## 7. Risqe në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Procesi i vendimmarjës në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbën një faktor rishku, ku fokusi kryesor dhe të gjitha masat që mund të ndërmerrin për të minimizuar rishkun në drejtëm të menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të përqëndrohen në:

- procesin e rekrutimit dhe promovimeve në karrierë,
- lëvizjet në detyrë,
- trajnimi dhe kualifikimin e punonjësve.

Për këtë arsy me qëllim rritjen e transparencës, meritokracisë dhe llogaridhënieς, **rekomandohet**:

- rritje e kontrollit për realizimin e procedurave të brendshme mbi mënyrën e rekrutimit të punonjësve,
- sanksionimin në mënyrë të qartë të emërimeve të stafit me kontratë sipas Kodit të Punës dhe sipas ligjit organik,
- publikimin në faqen zyrtare të institucionit të vendeve vakante, kritereve përgjedhëse ashtu si dhe rezultateve,
- zbatimi korrekt i procedurave të parashikuara për rekrutimin dhe vlerësimin e dokumentacionit;
- hartimi i kërkesave specifike, aftësive, cilësive dhe kriteret që duhet të plotësojë dhe përgjegjësitë e vendit të shpallur të punës për çdo pozicion pune;
- standardizimi i përshkimeve të punës;
- vlerësimet objektive të punës;
- promovimi në karrierë në bazë të meritokracisë.

## 8. Risqe në fushën e menaxhimit financiar

Sa i përket fushës së menaxhimit financiar procesi riskohet:

**Së pari:** Në drejtëm të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, ku planifikimi i nevojave të shpenzimeve, dhe pamundësia për të zhvilluar parashikime reale mund të çojë në probleme gjatë ekzekutimit të buxhetit dhe realizimit të objektivave të çdo programi.

Në këtë aspekt **rekomandohet** rritja e kontrollit të brendshëm dhe drejtimi i vazhdueshëm dhe korrekt i proceseve të menaxhimit financiar, por dhe të shpenzimit të shumave të alokuara, të cilat përbëjnë masa thelbësore në drejtëm të parandalimit dhe uljes së riskut të korruptionit.

**Së dyti:** Në drejtëm të menaxhimit të automjeteve në dispozicion të Agjencisë ku evidentohet risk në:

- Përdorimin e automjeteve në dispozicion të institucionit edhe nga funksionarë;
- Përdorimin e automjeteve nga personeli në mungesë të dokumentacionit standard justifikues për disiplinimin e lëvizjes së automjeteve dhe qëllimin e shërbimit;

- Mungesën e transparencës sa i përket ndjekjes dhe dokumentimit të shpenzimeve për karburant, të automjeteve që janë në dispozicion të institucionit.

Për të minimizuar risqet e identikuara më sipër, **rekomandohen** masat si më poshtë:

- Hartimi dhe zbatimi i rregullave të qarta dhe specifike për përdorimin dhe shfrytëzimin e automjeteve;
- Pajisja me fletëinventarët e përditësuara të çdo individi;
- Hartim dhe zbatim i procedurave standarde të punës.

**Së treti:** Në drejtim të trajtimit të proceseve administrative dhe gjyqësore, nisur dhe nga impakti që ata mund të kenë në integritetin institucional nëpërmjet:

- Krijimit të një situate më të favorshme ose lehtësira në gjyq bazuar në interesat privatë apo lidhjet personale;
- Mungesa e profesionalizmit në hartimin e akteve ligjore dhe gjyqësore, si në aspektin procedural ashtu edhe kohor;
- Lëshimit të informacioneve konfidenciale tek personat e paautorizuar.

**Nga sa më sipër, rekomandohet:**

- kontroll i vazhdueshëm mbi veprimtarinë e sektorit;
- rritje e hetimeve të brendshme;
- rritje e njohurive mbi përdorimin e informacionit të klasifikuar;
- trajnime të vazhdueshme dhe cilësore mbi hartimin e akteve juridike dhe ndryshimet ligjore;
- pajisje dhe njohje me kushtet e certifikatës së sigurisë. Masat e përcaktuara kanë për qëllim përgjigjen ndaj risqeve të identikuara dhe synojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe nivelit të ekspertizës, kontrollit dhe ndarjen më të mirë të përgjegjësive.

## 9. Risqet në fushën e arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit

Disa nga risqet e evidentuara në fushë e arkivimit ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit janë:

- Aksesi në informacionin e klasifikuar të personave të pacertifikuar;
- Lëshimi i informatave konfidenciale tek personat e paautorizuar;
- Dhënia e informacionit subjekteve që janë në proces verifikimi për pajisjen me Certifikatë Sigurimi Personeli (CSP);
- Kushte të papërshtatshme të sigurisë në ambientet ku administrohet dokumentacioni.

Në këtë kuadër, rekomandohet të merren disa masat që synojnë:

- zbatimin me rigorozitet të procedurave për pajisjen me certifikatë sigurie për informacionin e klasifikuar,
- rritjen e njohurive mbi administrimin e informacionit të klasifikuar,
- identifikimin dhe përmirësimin e mënyrës së qarkullimit të informacionit,
- përmirësimi i kushteve në rritje të sigurisë së ambjenteve ku ruhet dhe administrohet informacioni.

#### **10. Risqe që lidhen me cënimin e etikës, paanshmérinë, dinjitetit, mbrojtjen e reputacionit dhe imazhit të institucionit**

Krahas risqeve specifike të lidhura me sjelljet dhe veprimet korruptive, janë identifikuar dhe risqe që cënojnë etikën, dinjitetin e punonjësve e që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në imazhin dhe reputacionin e institucionit. Të tillë si:

- Sjellje diskriminuese, përjashtuese apo favorizuese të të gjitha formave, sjellje ngacmuese, bullizuese, presion, komunikim joetik apo dhunë verbale në vendin e punës;

Me qëllim parandalimin e veprimtarive dhe sjelljeve që dëmtojnë imazhin dhe integritetin e institucionit, **rekomandojmë**:

- trajnimin e punonjësve mbi kuadrin dhe mekanizmat ligjorë mbrojtës ndaj diskriminimit;
- respektim të barazisë gjinore dhe rritjen e ndërgjegjësimit në fushën e mbrojtjes së integritetit fizik dhe moral të punonjësit në ambientet e punës;
- evidentimin dhe marrjen e masave disiplinore për çdo shkelje të rëndë të etikës, dinjitetit dhe imazhit të institucionit;

#### **VI. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**

Objektivat strategjikë të parashikuara në këtë plan, do të implementohen nëpërmjet Planit të Veprimit për jetësimin e Planit të Integritetit, i cili parashikon afatet specifike, strukturat përgjegjëse dhe veprimet përkatëse.

Plani i Integritetit do t'i nënshtronhet një procesi monitorimi dhe vlerësimi, i cili do të kryhet me pjesmarrjen e përfaqësuesve që do të caktohen në të gjitha strukturat përgjegjëse.

Monitorimi bëhet me qëllim zbatimin e masave të ndërmarra në funksion të rritjes së Integritetit periodikisht çdo 6-muaj dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve për zbatimin e masave dhe përcaktion nëse ato kanë qënë efektive, sipas indikatorëve matës përkatës. Kjo do të shërbejë për të ndërmerrë veprime për rishikimin e masave ekzistuese dhe prioriteteve të risqeve, si dhe nxjerrjen e mesimeve për planifikimin më të mirë në të ardhmen.

Në kuadër të monitorimit, përfaqësuesit e strukturave përgjegjëse do të përgatisin dhe do të përcjellin tek koordinatori i caktuar nga titullari raportimet periodike.

Koordinatori realizon mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave duke përgatitur dhe përcjellë raportimet vjetore tëk pika e kontaktit për çështjet e antikorruptionit pranë Ministrisë së Brendshme.

## VII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Plani i Integriteti është një instrument që do të kontribuojë në mënyrë të qënësishme në menaxhimin e riskut, dhe në rritjen e nivelit të integritetit, efikasitetit dhe llogaridhënisë në radhët e punonjësve të Agjencisë, ku ballafaqimi efektiv me korrupsionin është me rëndësi jetike për të arritur rezultate më të larta në efektivitetin institucional.

Ky dokument strategik vjen në përputhje me prioritetet e parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2022-2024 dhe me standartet ndërkombëtare në këtë fushë.

Nëpërmjet tij synohet evidentitmi i risqeve, ndërmarrja e veprimeve konkrete dhe adresimi i tyre drejt zgjidhjeve adekuate çka përbëjnë mjete efektive në luftën kundër korrupsionit.

Pikërisht menaxhimi i riskut të integritetit përbën një faktor të shtuar rezistent ndaj shkeljeve të tij.

Për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit, është trajtuar kontributi i strukturave të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, duke u përqëndruar më së shumti tek identifikimi i faktorëve, burimeve, dhe shkaktarëve.

Vetë miratimi i ligjit të ri të Agjencisë, Rregullores dhe akteve të tjera nënligjore si VKM-ja mbi trajtimin financiar të punonjësve, përbëjnë mjete efektive që kontribuojnë në forcimin e integritetit institucional.

Nga ana tjetër përbushja e rekomandimeve të parashikuara në këtë plan brenda afatit 2-vjeçar do të influencojë pozitivisht në arritjen e objektivave të tij, rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së punonjësve në përbushjen e detyrave të tyre funksionale dhe minimizimin e subjektivizmit gjatë ushtrimit të detyrës.

Me miratimin e këtij plani ngarkohen të gjitha strukturat për njohjen dhe zbatimin e tij.